



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E MJEDISIT

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR INFORMACION NË FUSHËN E MJEDIST

Shkurt 2026

Nr. (1)	Data e regjistrimit të kërkesës (2)	Objekti (3)	Data e kthimit të përgjigjes (4)	Përgjigja(5)	Statusi i kërkesës (6)	Tarifa (7)
9	03.02.2026	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. A është aktualisht e lejuar gjuetia në Shqipëri dhe cili është logji ose akti ligjor që e rregullon atë?</p> <p>2. Cilat janë zonat ku lejohet ushtrimi i gjuetisë dhe a ekziston një listë ose hartë zyrtare e publikuar e këtyre zonave?</p> <p>3. A janë dhënë zona gjuetie për menaxhim subjekteve private?</p> <p>4. Nëse po, me çfarë procedure janë dhënë, për çfarë afati kohor, mbi bazën e cilave kritere?</p>	06.02.2023	<p>1. A është aktualisht e lejuar gjuetia në Shqipëri dhe cili është logji ose akti ligjor që e rregullon atë?</p> <p>Gjuetia është e rregulluar me ligjin Nr. 89/2025 “PËR GJUETINË”</p> <p>2. Cilat janë zonat ku lejohet ushtrimi i gjuetisë dhe a ekziston një listë ose hartë zyrtare e publikuar e këtyre zonave?</p> <p>Gjuetia zhvillohet vetëm në zonat për ushtrimin e gjuetisë që përfshihen në fondin pyjor dhe kullësor jashtë territorit të zonave të mbrojtura, në tokat bujqësore, në sipërfaqet ujore të brendshme, në toka të pafrytshme, të populluara me lloje të faunës së egër, objekt gjuetie, dhe shtrihen në sipërfaqe që janë me pronësi shtetërore apo private. Zonat e gjuetisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë, Aktet nënligjore do të hartohen brenda</p>	Përfunduar	0

	<p>5. Cilat janë speciet e kafshëve të egra që lejohet të gjuhet dhe cilat janë speciet e mbrojtura me ligj?</p> <p>6. Si përcaktohen periudhat e gjuetisë, kuotat ose kufizimet për speciet e lejuara dhe me cilat akte miratohen ato?</p> <p>7. Cilat institucione janë përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së gjuetisë dhe cilat janë masat ndëshkuese të parashikuara në rast shkeljesh.</p>		<p>3. A janë dhënë zona gjuetie për menaxhim subjekteve private? Jo</p> <p>4. Nëse po, me çfarë procedure janë dhënë, për çfarë afati kohor, mbi bazën e cilave kriteret?</p> <p>5. Cilat janë speciet e kafshëve të egra që lejohet të gjuhet dhe cilat janë speciet e mbrojtura me ligj? Nuk janë përcaktuar ende se cilat specie do të jene objekt gjuetie, llojet te cilat janë te mbrojtura në Republikën e Shqipërisë janë të listuar në Urdhrin 1280 datë 20.11.2013 “Për miratimin e listës se kuqe te florës dhe faunës se egër”.</p> <p>6. Si përcaktohen periudhat e gjuetisë, kuotat ose kufizimet për speciet e lejuara dhe me cilat akte miratohen ato?</p> <p>Gjuetia do te ushtrohet vetëm brenda sezonit të hapur për gjueti, duke respektuar periudhën e riprodhimit, derisa të vegjlit të ndahen nga nëna, si dhe periudhën e foljezimit, derisa të vegjlit të mësojnë të fluturojnë. Sezoni i hapur për gjueti përcaktohet sipas kriterëve gjeografike, klimatike dhe miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për gjuetinë. Për çdo vit ministria publikon hapjen e sezonit të gjuetisë në faqen e saj zyrtare.</p> <p>Kohëzgjatja e gjuetisë sipas llojeve, si dhe ditët e lejuara për gjueti, brenda sezonit të gjuetisë, caktohen me urdhër të ministrit.</p> <p>Dita e gjuetisë fillon pas lindjes së diellit dhe përfundon me perëndimin e tij.</p> <p>7. Cilat institucione janë përgjegjëse për monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së gjuetisë dhe cilat janë masat ndëshkuese të parashikuara në rast shkeljesh.</p>		
--	--	--	--	--	--

				<ul style="list-style-type: none"> <li>· Kontrolli dhe inspektimi për gjuetinë kryhen nga struktura përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për inspektimin.</li> <li>· Struktura përgjegjëse që mbulon natyrën dhe biodiversitetin pranë njësisë të vetëqeverisjes vendore bashkëpunon me strukturat e policisë bashkiake, në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe me legjislacionin në fuqi për policinë bashkiake.</li> <li>· Për çdo rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij, zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për inspektimin, si dhe mbahet një procesverbal që nënshkruhet nga hartuesi, shkelësi dhe dëshmitari i pranishëm dhe, në mungesë të dëshmitarit, procesverbali është i vlefshëm vetëm me nënshkrimin e menaxhuesit të zonës së gjuetisë apo të inspektorit të organeve të kontrollit.</li> <li>· Gjahu i vrarë ose i kapur konfiskohet, leja e gjuetisë i merret gjuetarit, armët e mjetet e gjahut sekuestrohen me procesverbal dhe i dorëzohen Policisë së Shtetit. Arma e sekuestruar i kthehet gjuetarit sezonin e ardhshëm pasi ka likuiduar gjobën përkatëse.</li> <li>· Masat e parashikuara në pikën 4 të këtij neni përbëjnë masa plotësuese, që mund të jepen krahas dënimit kryesor me gjobë ose ndëshkime të tjera të parashikuara në ligj.</li> </ul>		
10	03.02.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me: A është ngritur dhe funksionon aktualisht Komisioni Kombëtar për Ajër të Pastër	05.03.2026	<p>Përshendetje ne vijim te kerkeses tuaj ju bejme me dije si vijon:</p> <p>Komisioni Kombëtar për Ajër të Pastër (KKAP) është ngritur me Urdhrin nr. 98, datë 20.06.2024, të Kryeministrit.</p>	Përfunduar	0

		<p>(KKAP), i krijuar me Urdhrin nr. 98, datë 20.06.2024?</p> <p>2. Cila është përbërja e këtij Komisioni (institucionet dhe emrat e anëtarëve)?</p> <p>3. Sa mbledhje ka zhvilluar KKAP që nga krijimi i tij e deri më sot dhe në cilat data?</p> <p>4. A janë hartuar raporte, analiza apo dokumente zyrtare mbi gjendjen e cilësisë së ajrit nga KKAP? Nëse po, do ju lutesha për kopje të tyre.</p>	<p>2 Në zbatim të këtij urdhri, Komisioni kryesohet nga Zëvendësministri i Mjedisit, dhe ka këtë përbërje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· Përfaqësues i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM);</li> <li>· Përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;</li> <li>· Përfaqësues i Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;</li> <li>· Përfaqësues i Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI);</li> <li>· Përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;</li> <li>· Përfaqësues nga Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;</li> <li>· Përfaqësues nga Instituti i Shëndetit Publik;</li> <li>· Përfaqësues nga INSTAT;</li> <li>· Përfaqësues i Agjencisë për Mbështetjen dhe Vetëqeverisjen Vendore;</li> <li>· Përfaqësues i Industrisë;</li> <li>· Përfaqësues i Shoqërisë Civile;</li> <li>· Përfaqësues i Fakultetit të Shkencave të Natyrës;</li> </ul> <p>3. Në lidhje me pyetjen tuaj për mbledhjet e organizuara, ju informojmë se në shtator 2025 u krijua Ministria e Mjedisit si institucion më vete, pas ndarjes nga Ministria e Turizmit, çka ka sjellë një proces të domosdoshëm riorganizimi dhe konsolidimi institucional. Në këtë kuadër është formalizuar edhe struktura e Drejtorisë së Ajrit, duke krijuar për herë të parë një njësi të dedikuar për këtë fushë. Paralelisht, po vijon rishikimi i bazës ligjore</p> <p>për cilësinë e ajrit në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe finalizimi i Strategjisë dhe Planit Kombëtar për Cilësinë e Ajrit në Mjedis. Pas përfundimit të këtyre proceseve do të përcaktohen datat për organizimin e mbledhjeve në kuadër të këtij Komisioni.</p> <p>4. Ju informojmë se, sipas përcaktimeve të Urdhrit të Kryeministrit, Komisioni nuk ka si përgjegjësi hartimin apo nxjerrjen e raporteve, analizave apo dokumenteve zyrtare mbi</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>gjendjen e cilësisë së ajrit. Roli i tij konsiston në koordinimin ndërinstitucional, nxitjen e bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse për fushën e ajrit, si dhe në dhënien e rekomandimeve për institucionin politikbërës në këtë fushë. Në këtë kontekst, koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional kanë qenë të vazhdueshme, veçanërisht gjatë procesit të “screening”-ut në kuadër të integritimit evropian. Gjithashtu, institucionet përkatëse kanë qenë të përfshira në hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Cilësinë e Ajrit, të cilat përbëjnë dokumentet bazë në këtë fushe.</p>		
11	12.02.2026	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. Cila ka qenë kategoria e mbrojtjes për këtë zonë (p.sh. peizazh i mbrojtur, park natyror, monument natyror, etj.)?</p> <p>2. Ju lutem na vini në dispozicion hartën zyrtare që përcakton kufijtë e zonës së mbrojtur, ku përfshihet ose ka përfshirë zona e Rrjollit.</p> <p>3. A ka pasur ndryshime në statusin e mbrojtjes së kësaj zone ndër vite?</p> <p>Nëse po:</p> <p>Cilat janë aktet ligjore që kanë ndryshuar kufijtë ose kategorinë e mbrojtjes?</p> <p>Në cilat data janë miratuar këto ndryshime?</p>	25.02.2026	Kthyer pergjigje nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.	Përfunduar	0

		<p>5. A është hequr plotësisht ose pjesërisht statusi i zonës së mbrojtur për territorin ku parashikohet projekti turistik në Rrjoll?</p> <p>Nëse po:</p> <p>Me cilin akt ligjor është bërë kjo?</p> <p>Në cilën datë ka hyrë në fuqi?</p> <p>6. Ju lutem na vini në dispozicion çdo dokument apo vendim që lidhet me ndryshimin e statusit të zonës së mbrojtur në territorin e Rrjollit gjatë 15 viteve të fundit.</p>				
12	12.02.2026	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me: Kopje të mendimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, i cili i është bashkëlidhur relacionit shpjegues për udhëzimin e përbashkët “Për miratimin e rregullores teknike mbi standartet për trajtimin e ujërave të ndotur për subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotur dhe të patrajuara pranë ose në ujëra larës”</p>	05.03.2026	<p>Në vijim të kërkesës së paraqitur nga Qendra Res Publica për vënien në dispozicion të kopjes së mendimit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit në relacionin shpjegues për projekt-udhëzimin e përbashkët “Për miratimin e rregullores teknike mbi standartet për trajtimin e ujërave të ndotura për subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura dhe të patrajuara pranë ose në ujëra larës”, ju bëjmë me dije sa vijon:</p> <p>Udhëzimi përbashkët nr. 1, datë 01.02.2024, nuk përbën akt të Këshillit të Ministrave dhe nuk i nënshtrohet procedurës së shqyrtimit si projektakt sipas parashikimeve të VKM nr. 584/2003.</p> <p>Sa i përket bashkërendimit ndërinstitucional, konsultimi dhe dakordësimi ndërmjet institucioneve përkatëse janë realizuar përmes takimeve të drejtpërdrejta dhe komunikimit të vazhdueshëm institucional, duke siguruar dakordësimin e plotë mbi përmbajtjen e aktit.</p>	Përfunduar	0

				<p>Referuar dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga arkiv-protokolli, rezulton se Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 1121/1 prot., datë 01.02.2024, të protokolluar në Ministrinë e Mjedisit me nr. 819 prot., datë 01.02.2024, ka dërguar për bashkëfirmosje projekt-udhëzimin e përbashkët “Për miratimin e rregullores teknike mbi standardet për trajtimin e ujërave të ndotura për subjektet që shkarkojnë ujëra të ndotura dhe të patrajuara pranë ose në ujëra larës”. Projekt-udhëzimi shoqërohet me relacion shpjegues, por jo në kuptimin e VKM nr. 584/2003, pasi ky akt nuk i nënshtrohet procedurës së shqyrtimit sipas kësaj VKM-je, duke qenë se nuk kalon për shqyrtim pranë Këshillit të Ministrave.</p> <p>Gjithashtu, ju bëjmë me dije se ky udhëzim ka qenë objekt shqyrtimi gjyqësor pranë Gjykatës së Apelit Administrativ, e cila ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë dhe lënien në fuqi të këtij akti.</p>		
13	13.02.2026	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me: Kopje të dokumentacionit në lidhje me dosjen e plotë të përfshirjes së Luginës së Vjosës në programin “Njeriu dhe biosfera”, konkretisht kërkojmë që të na vihet në dispozicion dokumentacioni i plotë, ku përfshihet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>· Përshkrimin e detajuar të zonës dhe statusin e saj;</li> <li>· Hartat shoqëruese zyrtare;</li> </ul>	Në proces	Përfunduar	0	

		<ul style="list-style-type: none"> <li>· Përcaktimin e kufijve të jashtëm të zonës;</li> <li>· Kufijtë e përcaktuar të nënzonimit, sipas kategorive përkatëse.</li> </ul>				
14	16.02.2026	<p>Kerkese per informacion ne lidhje me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Si është vlerësuar përputhshmëria e projektit me legjislacionin për pyjet dhe fondin kullosor?</li> <li>2. Si është vlerësuar përputhshmëria e projektit me kategorinë e përdorimit të tokës në PPV, ku territori klasifikohet si sistem natyror me funksion konservimi?</li> <li>3. Si është trajtuar ndryshimi i përdorimit të territorit nga zonë natyrore në zonë infrastrukturore energjetike?</li> <li>4. Si është marrë në konsideratë statusi i zonës “Vargmali i Moravës” si zonë me përparësi zhvillimin e turizmit gjatë procesit të vlerësimit mjedisor?</li> <li>5. Si është vlerësuar ndikimi i projektit në peizazh dhe zhvillimin turistik të zonës?</li> </ol>	05.03.2026	<p>Lidhur me kërkesën për informacion për projektin “Parku Eolik Qarr-Kozel 55 MW”, për sa I takon fushës se përgjegjësisë se Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave ju bëjmë me dije se, nuk kemi patur kërkesë për ndryshim sipërfaqe për ndërtimin e parkut eolik dhe nuk është kryer asnjë procedurë në vijim të këtij projekti.</p> <p>Nëpërmjet sistemit e-akte, është dhënë mendimi teknik për projekt vkm e paraqitur nga MIE.</p>	Përfunduar	0

	<p>6. Si është trajtuar infrastruktura e aksesit në zonën e projektit gjatë procesit të vlerësimit mjedisor?</p> <p>7. Kush është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kushteve të vendimit të VNM-së? Në dokumentacionin e vlerësimit mjedisor nuk rezulton të jetë trajtuar në mënyrë të veçantë afërsia e ndërhyrjeve me prona private ekzistuese në zonë. Në këtë kuadër kërkohet sqarim mbi sa vijon:</p> <p>8. A janë identifikuar prona private në afërsi të zonës së projektit gjatë procesit të vlerësimit mjedisor?</p> <p>9. A është vlerësuar ndikimi i projektit në përdorimin dhe vlerën ekonomike të pronave private përreth?</p> <p>10. A janë informuar ose konsultuar pronarët privatë gjatë procesit të VNM-së? Në dokumentacionin e VNM-së paraprake parashikohet përdorimi i turbinave eolike të tipit Nordex N163/6.X. Sipas dokumentacionit teknik të prodhuesit, këto turbina kanë nivele zhurme në burim rreth 105–107 dB(A), çka kërkon modelim akustik të detajuar për të vlerësuar ndikimin në territorin</p>				
--	--	--	--	--	--

		<p>përreth. Në këtë kuadër kërkohet sqarim mbi vlerësimin e ndikimit akustik të projektit:</p> <p>11. A është realizuar modelim akustik për projektin gjatë procesit të VNM-së paraprake?</p> <p>12. Cilat janë nivelet e zhurmës të parashikuara në kufirin e pronave private më të afërta?</p> <p>13. Me cilat standarde ligjore ose teknike janë krahasuar këto nivele?</p> <p>14. Si është arritur në përfundimin se projekti nuk paraqet ndikim të rëndësishëm akustik në territorin përreth?</p> <p>15. Cili institucion do të verifikojë përputhshmërinë e niveleve reale të zhurmës gjatë operimit të projektit?</p>				
15	17.02.2026	<p>Kërkese për informacion në lidhje me: A ka Ministria e Mjedisit një plan të menaxhimit të sedimenteve për basenet kryesore ujore? Nëse po, kërkohet të më vihet në dispozicion.</p> <p>· Sa shpesh kryhet pastrimi ose menaxhimi i sedimenteve në basenet kryesore ujore?</p>	05.03.2026	<p>Në vijim të kërkesës së ardhur për informacion si më poshtë vijon përgjigja:</p> <p>Referuar ligjit nr. 29/2024 “Për burimet ujore”, të ndryshuar, kompetencat për administrimin, monitorimin dhe menaxhimin e burimeve ujore dhe baseneve lumore i përkasin Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), i cila është autoriteti teknik dhe ligjor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, ndaj dhe kërkesa duhet adresuar tek AMBU.</p> <p>Për këtë arsye çështjet që lidhen me menaxhimin e sedimenteve, pastrimin e shtratit të lumenjve, ndërhyrjet në</p>	Përfunduar	0

		<ul style="list-style-type: none"> <li>· Kërkoj të më vihet në dispozicion një listë e ndërhyrjeve në basenet kryesore për 5 vitet e fundit.</li> <li>· A janë identifikuar segmente lumenjsh me ngritje të shtratit për shkak të sedimenteve? Cilat janë ato?</li> <li>· A ka vërejtur Ministria e Mjedisit raste në të cilat digat dhe</li> </ul>		<p>basenet ujore, identifikimin e segmenteve me ngritje shtrati, si dhe administrimin hidromorfologjik i trupave ujore, nuk janë ne kompetence e Ministrisë së Mjedisit.</p> <p>Gjithashtu nuk kemi patur kërkesa te reja për HEC, dhe as raportime për sedimentim.</p>		
16	18.02.2026	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me: Cili është interpretimi zyrtar i Ministrisë mbi nenin 5 të Aktit Normativ nr. 8/2023 dhe kufijtë e delegimit normativ që ai parashikon?</p> <p>2. Si justifikohet përfshirja në Udhëzim e subjekteve “të lidhura ose jo me rrjetin publik të kanalizimeve”, kur Akti Normativ synon subjektet që nuk trajtojnë dhe shkarkojnë ujëra të patrajtuara?</p> <p>3. A është hartuar opinion ligjor i brendshëm për përputhshmërinë e nenit 6 të Udhëzimit me Aktin Normativ?</p> <p>4. A është kryer analizë shkencore ose teknike që vërteton se impiantet individuale për subjekte</p>	05.03.2026	<p>Në përgjigje të kërkesës bëjmë me dije se:</p> <p>Të gjithë operatorët e pajisur me Leje Mjedisore me Kod III.1.B, III.1.C dhe licenca të nënkategorisë III.2.B janë të publikuara në regjistrin kombëtar të autorizimeve, lejeve dhe licencave në QKB, bazuar në ligjin Nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Bashkëlidhur link:</p> <p><a href="https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/">https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-kombetar-te-licencave-autorizimeve-dhe-lejeve/licensat-lejet-e-leshuara-nga-qkb/</a>.</p> <p>Gjithashtu ju informojmë se në faqen zyrtare të AKM-së është e publikuar lista e subjekteve të pajisura me leje mjedisi periudha janar 2014- janar 2026:</p> <p><a href="https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/">https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-lejet-e-mjedisit-tipi-a-b-per-periudhen-janar-2014-korrik-2024/</a>.</p>	Përfunduar	0

	<p>të lidhura me UK përmirësojnë cilësinë e ujërave larëse?</p> <p>5. A është kryer analizë e ndikimit kumulativ mjedisor të instalimit të qindra impianteve private?</p> <p>6. A ekziston raport vlerësimi mjedisor që krahason modelin e trajtimit të centralizuar me modelin e trajtimit të fragmentuar?</p> <p>7. A është kryer analizë mbi kapacitetin real monitorues të shtetit për kontrollin e impianteve individuale?</p> <p>8. A ka identifikuar Ministria ndotësit kryesorë të ujërave larëse sipas të dhënave të AKM për vitet 2021–2024?</p> <p>9. Sa përqind e ndotjes atribuohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• shkarkimeve urbane?</li> <li>• impianteve publike jo-funksionale?</li> <li>• shkarkimeve industriale?</li> <li>• strukturave turistike të lidhura me UK?</li> </ul> <p>10. Pse masa është fokusuar kryesisht te bizneset turistike bregdetare dhe jo te ndotja urbane në brendësi të territorit?</p>		<p><a href="https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-licencat-iii-2-b-per-periudhen-2012-maj-2024/">https://akm.gov.al/ova_doc/baza-e-te-dhenave-per-licencat-iii-2-b-per-periudhen-2012-maj-2024/</a>.</p> <p>Për një informacion më të saktë mbi operatorët të pajisur me leje mjedisi, Ju duhet t'i drejtoheni QKB-së e cila mban dhe administron regjistrin kombëtar të licencave dhe lejeve.</p> <p>Në pyetjet e renditura, Drejtoria e Menaxhimit të të Dhënave Mjedisore, Kimikateve, Analizave Laboratorike dhe Inovacionit shprehet se vetëm pyetja 8 është në fushën tonë të përgjegjësisë, ku sqarojmë si më poshtë:</p> <p><b>A ka identifikuar Ministria ndotësit kryesorë të ujërave larëse sipas të dhënave të AKM për vitet 2021–2024?</b></p> <p>Në skemën e monitorimeve të cilësisë së ujërave që AKM realizon përfshihet edhe monitorimi i cilësisë së plazheve që konsiston në <b>monitorimin mikrobiologjik të ujërave bregdetare të larjes</b>.</p> <p>Monitorimi kryhet në 123 stacione kampionimi që prej vitit 2022, nga 119 që ka qene për vitin 2021 në plazhet kryesore të bregdetit të tilla si: plazhet e Velipojës, Shëngjinit, Tales, Durrësit, Gjiri i Lalzit, Kavajës, (Qerret, Spille), Divjakës, Semanit, Vlorës, (Zvërnec, Orikum), Palasës, Drimadhes, Dhërmiut, Jalës, Livadhes, Himarës, Qeparoit, Borshit, Lukovës, Sarandës, Ksamilit, Pogradecit, Linit, monitorim i cili realizohet përgjate sezonit turistik 15 Maj – 30 Shtator me 9 seri kampionimi, si dhe është realizuar inspektimi higjieno-sanitar për vlerësimin mikrobiologjik të tyre.</p> <p>Monitorimi ka qëllim të mbrojtë shëndetin publik, nëpërmjet vlerësimit të ngarkesës bakteriale <b>ku burimi i ndotjes janë</b></p>		
--	---	--	--	--	--

		<p>11. A konsideron Ministria se trajtimi i ujërave urbane është funksion publik?</p> <p>12. A është analizuar nëse Udhëzimi përbën transferim të përgjegjësisë nga shteti te subjektet private?</p> <p>13. Sa impiante publike të trajtimit janë aktualisht plotësisht funksionale?</p> <p>14. A është njoftuar Komisioni European për këtë ndryshim të modelit të trajtimit?</p>	<p><b>shkarkimet e ujërave urbane të patrajuara në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte, të cilat shkaktojnë ndotje të këtyre ujërave duke u reflektuar qarte edhe ne ngarkesat e larta mikrobiale te vleresuara ne pikun e sezonit duke sjelle si rrjedhoje edhe përkeqësim te cilësisë se stacioneve te monitoruara.</b></p> <p>Mostrat e ujërave bregdetarë të larjes analizohen për 2 tregues bakteriologjike:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Intestinal Enterococci</i> (IE)</li> <li>2. <i>Escherichia Coli</i> (probabilisht <i>E.coli</i>)</li> </ol> <p>Raportet janë të aksesueshme në faqen zyrtare të AKM <a href="http://www.akm.gov.al">www.akm.gov.al</a></p>		
17	19.02.2026	<p>Kërkesë për informacion në lidhje me: 1. Të gjitha lejet e dhëna për ndërhyrje në fondin pyjor në zonën Qukës-Qafë Plloçë në lidhje me projektin Qukes-Qafe Plloce Loti 1 realizuar nga bashkimi i kompanive “*****” për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>2. Të gjitha akt-ekspertimet pyjore të hartuar dhe të miratuar për këtë zonë, përfshirë sipërfaqet e prekura, llojet e pyjeve (p.sh. pyll gështenjash), vlerësimet e dëmit dhe masat kompensuese të parashikuara në lidhje me projektin Qukes-Qafe Plloce Loti 1 realizuar nga bashkimi i</p>	Në proces		

	<p>kompanive “*****” për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>Çdo dokument tjetër shoqërues, procesverbale kontrolli, masa rehabilitimi dhe detyrime të vendosura për subjektet që kanë ndërhyrë për projektin Qukes-Qafe Plloce Loti 1 realizuar nga bashkimi i kompanive “*****”.</p> <p>4. Të gjitha lejet e dhëna për ndërhyrje në fondin pyjor në zonën Qukës-Qafë Plloçë në lidhje me projektin Qukes-Qafe Plloce Loti 2 realizuar nga bashkimi i kompanive “*****” për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>5. Të gjitha akt-ekspertimet pyjore të hartuar dhe të miratuar për këtë zonë, përfshirë sipërfaqet e prekura, llojet e pyjeve (p.sh. pyll gështenjash), vlerësimet e dëmit dhe masat kompensuese të parashikuara në lidhje me projektin Qukes-Qafe Plloce Loti 2 realizuar nga bashkimi i kompanive “*****” për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>6. Çdo dokument tjetër shoqërues, procesverbale kontrolli, masa rehabilitimi dhe detyrime të vendosura për subjektet që kanë ndërhyrë për projektin Qukes-Qafe Plloce Loti 2 realizuar bashkimi i</p>				
--	---	--	--	--	--

	<p>kompanive “*****” për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>7. Të gjitha lejet e dhëna për ndërhyrje në fondin pyjor në zonën Qukës-Qafë Plloçë në lidhje me projektin Qukes-Qafe Plloce realizuar nga *****” për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>8. Të gjitha akt-ekspertimet pyjore të hartuar dhe të miratuar për këtë zonë, përfshirë sipërfaqet e prekura, llojet e pyjeve (p.sh. pyll gështenjash), vlerësimet e dëmit dhe masat kompensuese të parashikuara në lidhje me projektin Qukes-Qafe Plloce realizuar nga “*****” për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>9. Çdo dokument tjetër shoqërues, procesverbale kontrolli, masa rehabilitimi dhe detyrime të vendosura për subjektet që kanë ndërhyrë për projektin Qukes-Qafe Plloce Loti 2 realizuar nga “*****” për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>10. Të gjitha lejet e dhëna për ndërhyrje në fondin pyjor në zonën Qukës-Qafë Plloçë në lidhje me projektin Qukes-Qafe Plloce realizuar nga “*****” për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p>				
--	---	--	--	--	--

	<p>11. Të gjitha akt-ekspertimet pyjore të hartuar dhe të miratuar për këtë zonë, përfshirë sipërfaqet e prekura, llojet e pyjeve (p.sh. pyll gështenjash), vlerësimet e dëmit dhe masat kompensuese të parashikuara në lidhje me projektin Qukes-Qafe Plloce realizuar nga "*****" për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>12. Çdo dokument tjetër shoqërues, procesverbale kontrolli, masa rehabilitimi dhe detyrime të vendosura për subjektet që kanë ndërhyrë për projektin Qukes-Qafe Plloce Loti 2 realizuar nga "*****" për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>13. Të gjitha lejet e dhëna për ndërhyrje në fondin pyjor në zonën Qukës-Qafë Plloçë në lidhje me projektin Qukes-Qafe Plloce realizuar nga "*****" shpk për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>14. Të gjitha akt-ekspertimet pyjore të hartuar dhe të miratuar për këtë zonë, përfshirë sipërfaqet e prekura, llojet e pyjeve (p.sh. pyll gështenjash), vlerësimet e dëmit dhe masat kompensuese të parashikuara në lidhje me projektin Qukes-Qafe Plloce realizuar nga "*****" shpk për</p>				
--	---	--	--	--	--

	<p>Ilogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>15. Çdo dokument tjetër shoqërues, procesverbale kontrolli, masa rehabilitimi dhe detyrime të vendosura për subjektet që kanë ndërhyrë për projektin Qukes-Qafe Plloce Loti 2 realizuar nga "*****" shpk për Ilogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>16. Të gjitha lejet e dhëna për ndërhyrje në fondin pyjor në zonën Qukës-Qafë Plloçë në lidhje me projektin Qukes-Qafe Plloce realizuar nga "*****" shpk për Ilogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>17. Të gjitha akt-ekspertimet pyjore të hartuar dhe të miratuar për këtë zonë, përfshirë sipërfaqet e prekura, llojet e pyjeve (p.sh. pyll gështenjash), vlerësimet e dëmit dhe masat kompensuese të parashikuara në lidhje me projektin Qukes-Qafe Plloce realizuar nga "*****" shpk për Ilogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.</p> <p>18. Çdo dokument tjetër shoqërues, procesverbale kontrolli, masa rehabilitimi dhe detyrime të vendosura për subjektet që kanë ndërhyrë për projektin Qukes-Qafe</p>				
--	--	--	--	--	--

		Plloce Loti 2 realizuar nga "*****" shpk për llogari të Autoritetit Rrugor Shqiptar.				
18	23.02.2026	Mbi ankimin ndaj refuzimi për dhenie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare	25.02.2026	Kthyer përgjigje me shkres zyrtare	Përfunduar	0
19	23.02.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me: Për periudhën 2023–2025 kërkohet të më vihet në dispozicion informacioni/dokumentacioni mbi:  1. Cilët janë venddepozitimet e miratuara për depozitimin e inerteve dhe materialeve të ndërtimit në territorin e Bashkisë Tiranë ?  2. Sa është kapacitetin maksimal dhe sasinë e shfrytëzuar e miratuar nga Bashkia Tiranë për këto venddepozitime?  3. A ka një rregullore për sa i përket depozitimit, menaxhimit dhe administrimit të këtyre vendgrumbullimeve ,nëse po të më vihet në dispozicion.	05.03.2026	Kthyer përgjigje	Përfunduar	0
20	25.02.2026	Kërkesë për informacion në lidhje me: Cilat janë projektet Zhvillimore që po zhvillohen në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë?		Në proces		

		<ul style="list-style-type: none"> <li>· Cilat janë projektet zhvillimore a strategjike apo dhe ndërhyrje të tjera si HEC a diga në Parkun Kombëtar të Lurë- Mali i Dejes?</li> <li>· Cilat janë projektet strategjike a zhvillimore që po zhvillohen në Zonën e Mbrojtur Pishporo-Nartë?</li> <li>· Cilat janë projektet zhvillimore të planifikuara apo projektuara në Zonën e Parkut Kombëtar të Butrintit?</li> </ul>				
21	02.03.2026	Mbi ankimin ndaj refuzimi per dhenie te informacionit dhe kopje te dokumenteve zyrtare	05.03.2026	Kthyer pergjigje me shkres zyrtare	Përfunduar	0

**Shënim:**

**Regjistri përditësohet çdo muaj.**

- (1) Evidentohet kronologjia e kërkesave.**
- (2) Evidentohet nisja e shqyrtimit të kërkesës.**
- (3) Identifikohet lloji i kërkesës.**
- (4) Reflektohet afati i shqyrtimit të kërkesës dhe nëpërmjet klikimit njohja me përmbledhjen e përgjigjes.**

*(Të dhënat personale anonimizohen në përputhje me ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”)*

- (5) Ndhmon kërkuesin për të njohur ecurinë e procesit.**

**(6) Evidenton vlerat monetare për dhënie të dokumentacionit në përputhje me udhëzimet përkatëse.**